



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Drejtoria e Hetim Inspektimit

Nr. 387/1 Prot

Tiranë, më 10 / 4 / 2013

Lënda : Mbi kundërvajtjen administrative të kontrolluesit, “Tema Retail”, Tiranë.

VENDIM

Nr. 05, datë 10/04/2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të “Tema Retail”, Tiranë,

KONSTATOVA

Më datë 20/03/2013, nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit, “Tema Retail”, Tiranë, i cili mbledh dhe përpunon të dhëna personale të pacientëve, në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

1-Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale, sipas nenit 8 dhe 9 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, në lidhje me:

- Transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale.

Kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, “Tema Retail” Sh.p.k., Tiranë, u krye në bazë të informacionit të Drejtorisë së Regjistrimit, në lidhje me shkresën nr.1802/2prot., datë 26.08.2010, dërguar këtij kontrolluesi, si më poshtë vijon:

“Në zbatim të nenit 21 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Ju keni plotësuar dhe dërguar më datë 23.08.2010 Formularin e Njoftimit në Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Pas shqyrtimit të këtij deklarimi, nëpërmjet Formularit,

konstatuam se informacioni i deklaruar prej jush ka nevojë të plotësohet, saktësohet, si dhe të sqarohet, si më poshtë vijon:

Pikë së pari duke marr në konsideratë faktin se një shoqëri tregtare mund të përpunojë kategori të tjera subjektësh të të dhënave, përveç kategorisë së punëmarrësve, mendojmë të rishikohet nga ana juaj edhe një herë Rubrika 5, nëse ka kategori të tjera subjektësh që përpunohen, kategori këto që sigurisht do të lidhen me qëllimin e përpunimit (Rubrika 4).

Deklaroni te Rubrika 7 përunimin e të dhënave sensitive. Nisur nga kjo ju lutemi sqaroni:

1. Në cilin legjislacion bazohet përpunimi i këtyre të dhënave sensitive;
2. Në cilën formë informohet subjekti i të dhënave për përpunimin e të dhënave të tij sensitive;
3. Për sa kohë mbahen këto të dhëna.

Përsa i përket rubrikës 9, keni deklaruar se keni transferim të të dhënave personale jashtë vendeve të Bashkimit Evropian. Ky deklaram është i paplotë, pasi duhet të deklaroni duke specifikuar edhe subjektet marrëse të këtyre të dhënave që ndodhen në këtë vend, në respektim të nenit 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Ju rikujtojmë se nëse transferimi ndërkombëtar realizohet bazuar në dispozitat e nenit 8 të Ligjit, ju nuk keni nevojë të kërkontë autorizimin e Komisionerit. Nëse ky autorizim është i domosdoshëm, atëherë paraqitni kërkesë për dhënien e autorizimit, bazuar në nenin 9 të Ligjit për ato shtete që nuk kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, duke ju referuar edhe VKM-së Nr.934, datë 02.09.2009 “Për përcaktimin e shteteve, me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”. Sipas deklaramit tuaj, ju i transferoni të dhënat në Shtetin e Turqisë, i cili sipas V.K.M-së së sipërpërmendur nuk konsiderohet si vend me nivel të mjaftueshëm. Për listën e vendeve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, mund ti referoheni faqes tonë zyrtare: www.kmdp.al. Kjo listë është në përputhje me V.K.M-në e sipërpërmendur.

Në këto kushte, nëse transferimi i të dhënave nuk kryhet në përputhje me nenin 8/2 të Ligjit, ju duhet të paraqisni pranë Zyrës së Komisionerit kërkesën për Autorizimin e transferimit të të dhënave tek subjektet e shtetit të Turqisë, bazuar në nenin 9 të ligjit. Për paraqitjen e kësaj kërkesë, ju duhet të plotësoni “Formularin e Aplikimit për Autorizimin e transferimit në një shtet pa nivel të mjaftueshëm”. Ky formular mund të shkarkohet nga ju nga faqja zyrtare e zyrës, të plotësohet sipas pyetjeve dhe dokumentacionit që kërkohet në këtë formular, të printohet e firmoset dhe të dërgohet me postë pranë zyrës sonë.

Gjithashtu deklaramet e Nënrubrikës 9.2.5 janë të paplota. Ju lutemi rishikoni edhe një herë qëllimin e transferimit.

Për sa më sipër, bazuar në nenet 23 dhe 32/1 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, lutemi përcjelljen pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të informacionit plotësues e saktësues në formë shkresore brenda datës **06.09.2010.**”

Grupi i kontrollit, pasi u njoh me dosjen e paraqitur dhe informacionin përkatës, në datë 20.03.2013, ushtroi kontrollin pranë kontrolluesit, “Tema Retail” Sh.p.k., Tiranë.
Nga kontrolli i grupit të kontrollit u konstatua se:

-Kontrolluesi "Tema Retail" Sh.p.k. Tiranë, kryente transferim ndërkombëtar të të dhënave personale, dhe kjo ishte pika kryesore e objektit të kontrollit. Të dhënat personale të punonjësve që dërgohen në Turqi, sipas një formulari List pagese, konsistojnë si më poshtë vijon:

- emër, mbiemër
- Pozicioni
- Numri i llogarisë
- Depozita
- Paga bruto
- Orari i punës së ligjësuar, në muajin aktual
- Orët e punës në muajin aktual
- Paga neto

Të dhëna të tjera personale të punonjësve, që transferohen në Turqi, janë dhe të dhënat që mbledhen nëpërmjet kontratës midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, të cilat konsistojnë në:

- emër, mbiemër
- numri i kartës së identitetit
- vendlindja
- vendbanimi.

Gjithashtu, ky kontrollues rregjistrimet nga kamerat survejuese, të instaluar në dyqanet e tij, i dërgon në Turqi, dhe të drejtën e shkatërrimit apo të kthimit të këtyre rregjistrimeve e ka qëndra në Turqi. Faktin që ky kontrollues, ka të instaluar kamera survejuese, nuk e ka të deklaruar në rubrikën 4 dhe 6 të Formularit të Njoftimit. Tabela informuese nuk ka në ambientet e dyqaneve të këtij kontrolluesi.

Rubrika 9.2.3., rubrika "frekuenca e transferimeve", e deklaruar nga kontrolluesi "1 herë", në fakt konstatohet, se të dhënat e transferuara në zyrat qendrore në Turqi, sipa formularit të list pagesës, janë periodike; pra në çdo muaj.

Rubrika 9.2.5., rubrika "qëllimi i transferimit", është plotësuar nga kontrolluesi, "punësim", mirëpo nga dokumentacioni i mbledhur nga grupi i kontrollit, rezulton se nuk është vetëm ky qëllim, por dhe informim i përmuajshëm mbi mbarëvajtjen e aktivitetit.

-Për sa i përket pikave të tjera në informacionin e depozituar nga Drejtoria e Regjistrimit, ju informojmë, se të dhënat e tilla si të kategorizuara sensitive, "shëndeti" dhe "gjendja penale", këto të dhëna aplikanti i depoziton, pasi kontrolluesi, për natyrën e aktivitetit të tij, i punëson punëmarrësit sipas parashikimeve të Kodit të Punës.

Për pikat e tjera të konstatuara në këtë informacion të datës 20.12.2012, të Drejtorisë së Regjistrimit, kontrolluesi "Tema Retail" Sh.p.k., Tiranë, do të riformulojë Formularin e Njoftimit sipas konsulencës që i ofrohet nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe rekomandimet përkatëse.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh që ky kontrollues ka neglizhuar totalisht afatin e dërgimit të informacionit të kërkuar nga ky autoritet, në ushtrim të detyrimit ligjor. Ky afat ka qënë data 06.09.2010, dhe ka vazhduar të transferojë të dhëna personale të punonjësve të tij, në Turqi, ku është dhe qëndra e aktivitetit të këtij kontrolluesi.

Nisur sa më sipër, në zbatim të neneve 21-23, 30/2, 39/1,4; 40 e 41, të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, 107-109 të K.Pr.Administrative, si dhe Nenit 18/a, e të Ligjit Nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”:

V E N D O S A

1. Dënimin e kontrolluesit “Tema Retail” Sh.p.k., Tiranë, me gjobë, si më poshtë:
 - 1/a. Bazuar në nenin 39, paragrafi 1, gërma “a” të Ligjit nr.9887 datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale, me vlerën 500.000 (pesëqindmijë) lek.
2. Të mos transferohen të dhëna personale të punonjësve, duke përfshirë dhe rregjistrimet nga kamerat survejuese.
3. Transferimi i të dhënave, do të rifillojë pasi kjo praktikë të jetë ligjësuar sipas kushteve të parashikuara, nga nenet 8/2, gërmat “a”, “b”, “c”, neni 9, paragrafet 2 dhe 3 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar si dhe Udhëzimit nr.1, datë 19.02.2010 për “Lejimin e disa kategorive të transferimevendërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të rijaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”. Kryerja e këtij detyrimi të kryhet brenda një afati kohor, prej 30 (tridhjetë) ditësh.
4. Në zbatim të nenit 21 dhe 22 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të riformulohet dhe saktësohet Formulari i Njoftimit nga ana e kontrolluesit “Tema Retail” Sh.p.k., Tiranë.
Kryerja e këtij detyrimi të kryhet brenda një afati kohor prej 5 (pesë) ditësh.
5. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
6. Me kalimin e këtij afati, ky vendim shëndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit;
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit

Ky vendim u dha sot më datë, 08.04.2013.

Komisioneri
Flora Çabej (Pogaçe)

Në mungesë dhe me porosi

Këshilltari
Besnik Petrela

